



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 1967 prot.

Ballsh më, 29.04.2024

VENDIM

Nr. 25 Datë 24/04 2024

PËR TRANSFERIMIN E ASETIT DHE KAPITALIT TË OBJEKTIT “NDËRTIM I LINJËS SË JASHTME TË UJËSJELLËSIT RAJONAL MALLAKASTËR”, NË FAVOR TË SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME FIER

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzim nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve të në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar, VKB nr. 46, datë 30.08.2022 “Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të Ujësjiellës Kanalizimeve” Marrëveshjes së Bashkëpunimit për transferim aktiviteti nr. 1361 Rep., Nr. 619 Kol date 07.10.2022 ndermjet Sh.a Ujesjelles Kanalizime Mallakaster dhe Shoqerise Rajonale Ujesjelles Kanalizime Fier, VKB nr. 12, datë 24.02.2020 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit Bashkiak”, VKB nr. 67, datë 21.12.2023 “Për miratimin e përfundimit të likuidimit dhe çregjistrimin e shoqërisë UK Mallakastër”

VENDOSI

1. Transferimin e asetit dhe kapitalit të objektit “Ndërtim i linjës së jashtme të Ujësjiellës Rajonal Mallakastër”, me vlerë kontabël 48 445 593 lekë (dyzetë e tetëmilion e katërqind e dyzetë e pesëmijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë në favor të Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Fier.
2. Ky vendim shoqërohet me dokumentacionin përkatës.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6 e ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

KRYETAR

Nexhmi Sulaj

